



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1380/prot.  
13

Tiranë më 26.12.2017

VENDIM

Nr. 102, datë 26.12.2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë me përfaqësues Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1380 Prot., datë 18.10.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet shkresës së datës 09.09.2017, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Vënien në dispozicion të të gjitha vendimeve të dhëna nga Prokurori Mirela Kapo, nga momenti i emërimit të saj pranë kësaj prokurorie dhe deri datën e marrjes dijeni të kërkesës, kjo për qëllime shkencore, statistikore dhe hulumtuese, duke anonimizuar të dhënat personale dhe sensitive.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1380 Prot., datë 18.10.2017 pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1380/1 Prot, datë 24.10.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 30.10.2017.

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 128/3 Prot., datë 26.10.2017 duke sqaruar se: *Mbështetur në nenet 34, 58, 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale, kërkuesi nuk legjitimohet për tërheqjen e informacionit të kërkuar. Gjithashtu, bazuar në nenin 4, pika 4 e Ligjit nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nuk lejohet të pasqyrohet aktiviteti publik i punonjësit të administratës shtetërore. Neni 17, pika 1, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përcakton kufizimin e dhënies së informacionit pasi në aktet hetimore ndodhen të dhëna për jetën private të subjekteve. Aktet e hetimeve paraprake ndodhen në fashikuj të cilët janë arshivuar dhe për nxjerrjen e tyre jashtë institucionit duhet të veprohet duke u mbështetur tek neni 63 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat".*

Pas shqyrtimit të ankimit dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë është i regjistruar pranë Autoritetit Publik dhe si i tillë administrohet prej tij duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Gjithashtu, në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dhe dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, së bashku me kufizimet që ky ligj mund të përmbajë lidhur me publikimin e informacionit.

Për sa i përket argumentave të Autoritetit Publik lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit, sqarojmë se: gërma b) e pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, përcakton se ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave: *Vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.*

Arsyetimi i arshivimit të akteve të hetimeve paraprake nuk është objekt i kërkesës për informacion të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë, të cilët kanë kërkuar vendimet e dhëna dhe jo aktet e hetimeve paraprake.

Lidhur me kufizimin e përcaktuar në nenin 17, pika 1, gërma a) i Ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" që lidhet përkatësisht me cënimin e të drejtës për një jetë private, nuk prek në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, personat përgjegjës duhet ta vënë atë në dispozicion të kërkuesit bazuar në pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili përcakton se: "*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e*

dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, si dhe në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Pra, me qëllim përmbushjen e kërkesës për informacion, Autoriteti Publik duhet të kryejë anonimizimin e të dhënave personale të të gjitha vendimeve të dhëna nga Prokurori Mirela Kapo nga momenti i emërimit të saj pranë kësaj prokurorie dhe deri datën e marrjes dijeni të kërkesës.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë kundër Autoritetit Publik/ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë. Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 1380 Prof., datë 18.10.2017 të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë, ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës për informim datë 09.09.2017 në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe duke respektuar nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, brenda datës 5 . 01 . 2018
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot në datë 26. 12 . 2017.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

